

“Horizon” Shpk

Pasqyrat Financiare

për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017

Handwritten signature

“Horizon” Shpk

PERMBAJTJA:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCES	5
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	8
1. Informacion i pergjithshem	9
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile	10
3. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	12
4. Kerkesa tregtare dhe te tjera te arketueshme	12
5. Tatim fitimi i parapaguar	12
6. Te ardhura te perllogaritura dhe shpenzimet e shtyra	12
7. Aktive afatgjate materiale	13
8. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit, punonjesve & detyrimet tatimor	14
9. Provizione per shpenzime	15
10. Grante	15
11. Kapitali i nenshkruar	15
12. Te ardhurat te shfrytezimit	16
13. Shpenzime per materiale	16
14. Shpenzime personeli	16
15. Shpenzime te pergjithshme administrative	17
16. Shpenzimi i Tatimit mbi fitimin	17
17. Ngjarje te tjera pas dates bilancit	17

Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Gjithe vlerat ne Leke)

AKTIVET	Shenime	31 Dhjetor Viti 2017	31 Dhjetor Viti 2016
Aktiveve Afatshkurtra			
Mjete Monetare	3	49,278,986	29,059,709
Te drejta te arketueshme		46,249,920	54,016,779
1. Nga aktiviteti i shfrytezimit	4	45,079,072	50,691,924
2. Te tjera	4	3,230,649	3,121,509
3. Tatim fitimi i parapaguar	5	(2,059,801)	203,347
Inventaret:		45,848,099	45,521,626
1. Lende e pare dhe materiale te konsumueshme		116,152	51,635
2. Mallra		45,731,948	45,469,991
Shpenzime te shtyra	6	8,400,087	3,114,423
Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	6	3,303,471	-
Aktive Totale Afatshkurtra		153,080,564	131,712,538
Aktive Afatgjata			
Aktive Financiare:			
1. Tituj te tjere te huadhenies	7	2,418,500	2,418,500
Aktive Materiale			
1. Te tjera instalime dhe pajisje	8	3,352,345	3,701,377
2. Impjante dhe makineri	8	1,773,388	2,147,319
Aktive Jomateriale			
1. Koncesione, patenta, licensa, marka tregtare, te drejta dhe aktive te ngjashme	8	949,508	807,609
Aktive Totale Afatgjata		8,493,742	9,074,804
AKTIVE TOTALE		161,574,305	140,787,342

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

DETYRIME DHE KAPITALI**Detyrime Afatshkurtra:**

1. Arketime ne avance per porosi		-	599,931
2. Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	9	24,701,925	13,786,935
3. Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	10	457,701	440,955
4. Te pagueshme per detyrimet tatimore	11	1,740,406	2,908,016
5. Te tjera te pagueshme (Divident)		57,100,093	60,410,238
Te Ardhura te Shtyra		2,774,676	3,282,620
Provizione	12	-	125,363
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra		86,774,801	81,554,058

Detyrime Afatgjata:

Grande	13	31,597,772	34,018,706
Totali i Detyrimeve Afatgjata		31,597,772	34,018,706

DETYRIME TOTALE**118,372,573 115,572,765****Kapitali dhe Rezervat**

Kapitali i Nenshkruar	14	500,000	500,000
1. Rezerva ligjore		50,000	50,000
Fitimi i pashperndare		-	-
Fitimi i vitit		42,651,733	24,664,577
TOTALI I KAPITALIT		43,201,733	25,214,577

TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT**161,574,305 140,787,342**

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese jane firmosur dhe miratuar me 27 Mars 2018 nga:

Administratori
Vasileios StachosShefe Finance
Glediana Nakuci

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Performances

(Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)

(Gjithe vlerat ne Leke)

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhurat te shfrytezimit	15	149,504,637	82,959,588
Te ardhura te tjera		372,878	305,300
Te ardhurat nga grantet		3,814,204	2,436,366
Shpenzime per materiale	16	(31,265,353)	(20,086,828)
Shpenzime per konsulenca		(34,715,672)	(6,158,591)
Shpenzime personeli	17	(22,287,626)	(18,067,123)
1. Paga dhe shperblime		(19,917,958)	(16,040,020)
2. Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore		(2,369,668)	(2,027,103)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	18	(12,268,414)	(10,244,484)
Provizion per shpenzime tatimore		-	(125,363)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale		(1,548,319)	(1,349,665)
Rezultati nga veprimtarite shfrytezuese		51,606,336	29,669,200
Te ardhura/(shpenzime) financiare		(1,296,125)	(507,515)
Fitimi para tatimit		50,310,211	29,161,685
Shpenzimi i tatimi mbi fitimin	19	(7,658,478)	(4,497,108)
Fitimi i vitit		42,651,733	24,664,577
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse per vitin		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin		42,651,733	24,664,577

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare*(Gjithe vlerat ne Leke)*

Shenime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor	
	2017	2016
Flukse e mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitim /Humbja e vitit	50,310,211	29,161,685
Rregullime per shpenzimet jomonetare:	-	-
Shpenzime financiare jomonetare	-	-
Shpenzime per tatimin mbi fitimin jomonetare	-	-
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale	1,548,319	1,349,665
<i>Provizjon</i>	(125,363)	125,363
Fitimi nga veprimtarite shfrytezuese para ndryshimeve ne kapitalin punues	51,733,166	30,636,713
Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:		
<i>Renie/ (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera</i>	(3,173,116)	(12,102,182)
<i>Renie/ (rritje) ne inventar</i>	(326,473)	(4,854,244)
<i>Renie/ (rritje) e llogarive te pagueshme</i>	5,346,107	65,289,222
Tatim fitimi i paguar	(5,697,417)	(2,685,988)
Mjete monetare neto nga/perdorur veprimtarite e shfrytezimit	47,882,267	76,283,521
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e investimit		
Kredi nga aksioneri		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(967,256)	(3,799,387)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(967,256)	(3,799,387)
Flukse e mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit:		
Pagesa e huave	-	(2,418,500)

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017**

Dividende te paguar	(24,274,800)	(71,070,868)
Grante te marra	(2,420,934)	737,269
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	(26,695,734)	(72,752,099)
Rritja/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare	20,219,277	(267,965)
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne 1 Janar 2017	29,059,709	29,327,673
Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne 31 Dhjetor 2017	49,278,986	29,059,709

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto*(Gjithe vlerat ne Leke)*

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitimi i pashperndare	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar me 01 Janar 2016	500,000	50,000	48,316,365	22,754,503	71,620,868
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:					
Kapitali themeltar					-
Fitimi i vitit				24,664,577	24,664,577
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit 2016				-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	-	24,664,577	24,664,577
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te shpermdare			-		-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2015	500,000	50,000	48,316,365	22,754,503	71,620,868
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te shpermdare			(71,070,868)		(71,070,868)
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	(71,070,868)	-	(71,070,868)
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2016	500,000	50,000	-	24,664,577	25,214,578
Riklasifikim			24,664,577	(24,664,577)	
Dividende te shpermdare	-				-
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	24,664,577	(24,664,577)	-
Total			-	-	-
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit 2017:					
Kapitali themeltar					
Fitimi i vitit 2017				42,651,733	42,651,733
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit 2017				-	-
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2017	500,000	50,000	-	42,651,733	43,201,733
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te shpermdare			(24,664,577)		(24,664,577)
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	(24,664,577)	-	(24,664,577)
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2017	500,000	50,000	-	42,651,733	43,201,733

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria "Horizon" Shpk. (me poshte 'Shoqeria') eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne date 23/09/2005.

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise perfshin veprimtari ne fushen e teknologjise, duke ofruar krijimin dhe integrimin te sistemeve te informacionit per shoqeri dhe individe, import, eksport si dhe shitje te pajisjeve informatike, produkteve hardware dhe software dhe programe ne tregun vendas dhe ate te huaj.

Me 31 Dhjetor 2017 shoqeria kishte 14 te punesuar (31 Dhjetor 2016 : 15 punonjes). Adresa e shoqerise eshte rruga Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Nr. 27, Kati 4, Hyrja Nr. 19, Tirane. Shoqeria eshte regjistruar si tatimpagues ne rrethin e Tiranes me NIPT K52225004V.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017 jane miratuar nga Administratori i shoqerise me 27 Mars 2018.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga rregullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kosos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vetendertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjetere te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e cmontimit, heqjes se pjesëve dhe sjelljes si ne gjendjen e mepashme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkatës sipas kategorisë.

Ne rastet kur pjesë te një aktivi afatgjate material kanë jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii)Kostot e mepashme

Kostoja e zevendesimit te një pjese te një zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri neese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)**b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)**

pazon muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Norma e amortizimit per periudhën aktuale jane si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe paisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Te tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Aktive te patrupezuara (jomateriale)	Metoda Lineare	15%

Aktivt afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

c. Inventari

Inventaret jane paraqitur ne pasqyrat financiare te Shoqerise duke perdorur vleren e blerjes se tyre qe eshte me e vogel se vlera neto e realizueshme. Per inventarizim shoqeria ka perdorur metoden periodike dhe per vleresimin ka perdorur metoden e koston mesatare.

d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit per zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat ne Lek dhe ne monedha te huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

f. Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit ne datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM



PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)**f. Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)**

për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
1 EUR	132,95	135,23
1 USD	111.10	128,17

g. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

h. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2017. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2017 (2016: 15%).

i. Fondet per pensione

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetsore për punonjësit e saj sic është parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogaritë organizmave kombëtare përgjegjes për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetsore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetsore.

j. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

k. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi. Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017****3. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE ME TO**

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Vlera në arkë	3,780	25,593
Vlera në banka	49,275,205	29,034,115
Ne Lek	11,241,345	331,198
Ne Euro	17,521,407	24,570,350
Ne USD	20,516,233	4,132,568
Totali	49,278,985	29,059,709

4. KERKESA TREGTARE DHE TE TJERA TE ARKETUESHME

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit	45,079,072	50,691,924
Te tjera te arketueshme	3,230,649	3,121,509
Totali	48,309,721	53,813,432

5. TATIM FITIMI I PARAPAGUAR

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Gjendje ne fillim	203,347	2,014,467
Paguar Tatim fitimi vitit 2016	394,833	
Paguar gjate vitit	5,302,584	2,685,988
Kompensimi i detyrimit te tatim fitimit sipas NJV nr. Prot. 59696/3 dt. 27.12.2016 sipas ligjit te faljes	(302,087)	-
Tatim fitimi i vitit ushtrimor	(7,658,478)	(4,497,108)
Parapagim/(Detyrim) ne fund	(2,059,801)	203,347

6. TE ARDHURA TE PERLLOGARITURA DHE SHPENZIME TE SHTYRA

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime te shytyra	8,400,087	3,114,423
Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara	3,303,471	-
Totali	11,703,558	3,114,423

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017****7. TITUJ TE TJERE TE HUADHENIES**

Te drejta ndaj paleve te lidhura perbehet nga nje hua dhene Administratorit Vasileios Stachos ne 24 Maj 2016 ne vleren 17,500 Euro . Shuma nuk mbart interesa dhe nuk ka date te percaktuar te shlyerjes.

8. AKTIVE AFATGJATE MATERIALE

	Pajisje informatike	Pajisje zyre	Te tjera	Mjete Transporti	Aktive Jomateriale	Totali
Kosto						
Me 01 Janar 2016	10,276,915	3,747,425	494,157	695,900	-	15,214,397
Shtesa	790,992	(366,490)	710,405	1,757,490	906,990	3,799,387
Me 31 Dhjetor 2016	11,067,907	3,380,935	1,204,562	2,453,390	906,990	19,013,784
Shtesa	562,106	25,586	-	68,000	311,564	967,256
Me 31 Dhjetor 2017	11,630,013	3,406,521	1,204,562	2,521,390	1,218,554	19,981,039
Amortizimi i akumuluar						
Me 01 Janar 2016	(8,084,069)	(3,121,360)	(327,430)	(23,195)	-	(11,952,029)
Amortizimi per vitin	(659,523)	347,434	(107,081)	(282,874)	(99,381)	(801,426)
Me 31 Dhjetor 2016	(8,743,592)	(2,773,926)	(434,511)	(306,069)	(99,381)	(12,357,480)
Amortizimi per vitin	(657,272)	(125,440)	(154,011)	(441,930)	(169,665)	(1,548,319)
Me 31 Dhjetor 2017	(9,400,864)	(2,899,366)	(588,522)	(747,999)	(269,046)	(13,905,798)
						-
Vlera kontabel neto:						
Me 01 Janar 2016	2,192,846	626,065	166,727	672,705	-	3,658,343
Me 31 Dhjetor 2016	2,324,315	607,009	770,051	2,147,321	807,609	6,656,304
Me 31 Dhjetor 2017	2,229,149	507,154	616,040	1,773,391	949,508	6,075,242



Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

9. TE PAGUESHME PER AKTIVITETIN E SHFRYTEZIMIT

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitoret	24,701,925	12,602,921
Shpenzime te perlogaritura	-	1,184,014
Totali	24,701,925	13,786,935

10. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE DHE SIGURIMEVE SHOQERORE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Paga te pagueshme	112,611	123,228
Te pagueshme ndaj sigurimeve shoqerore	345,090	317,728
Totali	457,701	440,955

11. TE PAGUESHME PER DETYRIMET TATIMORE

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
TVSH e pagueshme, neto	1,645,563	2,719,067
Taksa dhe tatime te tjera	94,843	188,949
Totali	1,740,406	2,908,016

11.1 TE PAGUESHME PER DETYRIMET TATIMORE (VAZHDIM)**PARAPAGIM/ (DETYRIM) PER TVSH**

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	(2,719,067)	(2,276,407)
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	(28,531,777)	(15,921,407)
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	14,625,111	6,950,619
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	18,271,295	8,528,128
(Detyrime)/ Parapagim per TVSH	1,645,563	(2,719,067)



Horizon Shpk
Shenimet e pasqyrave financiare
Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

12. PROVIZIONE PER SHPENZIME

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Ne 1 Janar	-	-
Perdorur gjate vitit per penalitete e gjoba		
Kaluar si e ardhur gjate vitit		
Porvizione per rreziqe e shpenzime		
-Shtesa per ceshtje tatimore	-	125,363
Ne 31 Dhjetor	-	125,363

Provizionet per ceshtje tatimore perfaqesojne parashikimet e drejtimit per pagesen e gjobave dhe kamatvonesave sipas njoftim vleresimit tatimor ne Dhjetor 2016.

13. GRANTE

Subvencionet lidhen me pjese garancie falas nga furnitore te huaj dhe gjate 2017 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Subvencione ne fillim	34,018,706	33,281,437
Shtesa gjate vitit	(3,814,204)	(2,436,366)
Ri-marrje gjate vitit	1,393,270	3,173,636
Subvencione ne fund	31,597,772	34,018,706

14. KAPITALI I NENSHKRUAR

Duke u bazuar ne vendimin per miratimin e shitjes se kuotave qe ne dt. 13.07.2016 deklaruar ne QKB ne dt. 19.07.2016 ortaku i "Horizon" shpk eshte "Comscope Limited" me transferim te kuotave 100%.

Kapitali i nenshkruar dhe struktura aksionare me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2016	
	Ne %	Ne Vlere
"Comscope Limited"	100%	500.000
	<u>100%</u>	<u>500.000</u>
	31 Dhjetor 2017	
	Ne %	Ne Vlere
"Comscope Limited"	100%	500.000
	<u>100%</u>	<u>500.000</u>

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017**

Ne 31 Dhjetor 2017 kapitali akionar perbehej nga 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili (2015: 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili).

15. TE ARDHURA TE SHFRYTEZIMIT

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga shitje sherbime	125,595,441	70,485,102
Te ardhura nga shitje mallra	23,823,698	12,376,103
Te ardhura te tjera	85,498	98,382
Totali	149,504,637	82,959,588

"Ne shifren e afarizimit dhe TVSH e llogaritur ne blerje dhe shitje sipas sistemit tatimor eshte perfshire edhe vlere e tatueshme Lek 9,226,088 Leke (4,049,860 ne 2016) per autofaturimet sipas nenit 15. pika 5 te ligjit 7928 per "Tatimin mbli Vleren e Shtuar" e cila nuk perfaqeson nje te ardhur per shoqerine."

16. SHPENZIME PER MATERIALE

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Kosto e mallrave	27,465,958	17,650,462
Kosto e mallrave nga grantet	3,799,395	2,436,366
Totali	31,265,353	20,086,828

17. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2017	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2016
Pagat	19,917,958	16,040,020
Sigurimet shoqerore	2,369,668	2,027,103
Totali	22,287,626	18,067,123

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare**

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017

18. SHPENZIME TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur 31 December 2017	Viti i mbyllur 31 December 2016
Qira	2,897,088	2,750,647
Sherbime profesionale	1,495,018	1,106,242
Udhetime dhe dieta	450,222	705,998
Karburant	664,300	827,800
Uje, drita	473,476	387,003
Postare dhe komunikimi	1,102,106	1,352,784
Gjoha (kamatvonesa) dhe te tjera	26,382	5,049
Komisione bankare	698,103	233,355
Shpenzime te tjera operative	4,461,719	2,875,606
Totali	12,268,414	10,244,484

19. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

	31 December 2017	31 December 2016
Fitimi para tatimit	50,310,211	29,161,685
Te ardhura te patatueshme		
<i>Efekti tatimor i shpenzimeve qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore</i>		
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime mbi kufirin tatimor		
Gjoha dhe demshperblime (kamatvonesa)	26,382	5,049
Provizione per gjoha		125,363
Shpenzime pa dokumentacion te rregullt	353,852	548,520
Te tjera fatura		
Shpenzime marketingu		
Shpenzime te tjera	366,077	140,100
Fitimi i tatueshem	51,056,522	29,980,717
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	7,658,478	4,497,108

20. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te rendesishme pas mbylljes se vitit ushtrimor qe te kerkoje korrigjime apo pershkrime ne keto pasqyra financiare.

SHOQERIA: "HORIZON" SHPK
 NIPT: K52225004V

Pasqyra e Aktiveve Afatgjata Materiale

	Pajisje informatike	Pajisje zyre	Te tjera	Mjete Transporti	Aktive Jomateriale	Totali
Kosto						
Me 01 Janar 2016	10,276,915	3,747,425	494,157	695,900	-	15,214,397
Shtesa	790,992	(366,490)	710,405	1,757,490	906,990	3,799,387
Me 31 Dhjetor 2016	11,067,907	3,380,935	1,204,562	2,453,390	906,990	19,013,784
Shtesa	562,106	25,586	-	68,000	311,564	967,256
Me 31 Dhjetor 2017	11,630,013	3,406,521	1,204,562	2,521,390	1,218,554	19,981,039
Amortizimi i akumuluar						
Me 01 Janar 2016	(8,084,069)	(3,121,360)	(327,430)	(23,195)	-	(11,952,029)
Amortizimi per vitin	(659,523)	347,434	(107,081)	(282,874)	(99,381)	(801,426)
Me 31 Dhjetor 2016	(8,743,592)	(2,773,926)	(434,511)	(306,069)	(99,381)	(12,357,480)
Amortizimi per vitin	(657,272)	(125,440)	(154,011)	(441,930)	(169,665)	(1,548,319)
Me 31 Dhjetor 2017	(9,400,864)	(2,899,366)	(588,522)	(747,999)	(269,046)	(13,905,798)
Vlera kontabel neto:						
Me 01 Janar 2016	2,192,846	626,065	166,727	672,705	-	3,658,343
Me 31 Dhjetor 2016	2,324,315	607,009	770,051	2,147,321	807,609	6,656,304
Me 31 Dhjetor 2017	2,229,149	507,154	616,040	1,773,391	949,508	6,075,242

ADMINISTRATOR
 VASILEIOS-STAGHOS




SHOQERIA: "HORIZON" SHPK

NIPT: K52225004V

Inventari i mjeteve te transportit ne pronesi te subjektit 31.12.2017

Nr	Lloji i automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera fillestare
1	Ford Fiesta	1.4 TDCI	AA 782 MV	5,558.82 Euro
2	Ford Fiesta	1.4 TDCI	AA 854 NS	5,500 Euro
3	VW Touran	1.6 TDCI	AA 483 PF	7,200 Euro



ADMINISTRATOR
VASILEIOS STACHOS

Vasileios
Stachos

2931

KONTRATE QIRAJE

Majlinda E. Demollari
Taksa e Pulles
Para meje Noteres

Sot më datë 30.12.2015, në dhomën e Noterëve në Tiranë, para meje, Noteres Majlinda Demollari lidhet kjo kontratë sipërmarrje me palët dhe objekt të përshkruar si më poshtë :

- a) Shoqëria "PF Trade Tirana" sh.p.k., person juridik, i regjistruar më datë 01/04/1994, e pajisur me NIPT J82430001H, me seli në Tiranë rruga Ismail Qemali 27, e përfaqësuar nga Administratori i Vetëm saj **Z. Rauf FRATARI**, i biri i Hajredinit, lindur më 16/08/1992 në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me **letërnjoftim Nr.025077662**, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (këtu e më poshtë referuar si **Qiradhënësi**).

dhe

- a) Shoqëria "HORIZON" sh.p.k., person juridik, e regjistruar më datë 23.09.2005, e pajisur me NIPT K52225004V, me seli në Rr. Ibrahim Rugova, Green Park Tower, Kati II, Tirane, e përfaqësuar nga Administratori Vasileios Stachos, lindur më 11.06.1973 në Glyfada dhe banues në Tirane, identifikuar me kartë identiteti nr. AH3272763, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e më poshtë referuar si **Qiramarrësi**)

Palët kontraktuese bien dakord të lidhin kontratën me termat dhe afatet e mëposhtme:

Neni 1. Dispozita të Përgjithshme

- 1.1. Qiradhënësi është pronar me të drejte përdorimi i një pasurie 200 m² e vërtetuar me Certifikatë Pronësie të lëshuar nga ZRVPP Tiranë, në datë 15.03.2012 me të dhënat: Nr. Pasure 3/100+1-19, Zona Kadastrale Nr. 8270, Volumi 35, Faqe 18.
- 1.2. Qiramarrësi do të hyjë si palë në këtë Kontratë për nevoja të ushtrimit të aktivitetit privat.

Neni 2. Objekti

- 2.1. Objekt i kësaj kontrate do të jetë dhënia me qira (në gëzim të përkohshëm) i Pronës, në adresën e lartpërmendur. Qiradhënësi deklaron se ia jep me qira Qiramarrësit pronën në fjalë në përputhje me termat dhe afatet e përcaktuara në këtë kontratë.

Rauf Fratar

✓

- 2.2. Vendndodhja, të dhënat dhe kufizimet e pronës të dhënë me qira specifikohen në Çertifikatën e Pronësisë me të dhëna sa më sipër që i bashkëngjiten kësaj kontrate.

Neni 3. Kohëzgjatja

- 3.1. Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e dorëzimit të sendit, objekt kontrate, më datë 15 Janar 2016.
- 3.2. Palët bien dakord se kjo kontratë qiraje lidhet për një kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetësh, të cilat do të fillojnë të llogariten nga data 15 Janar 2016 deri më 1 Janar 2021.
- 3.3. Kjo kontratë përfundon me përfundimin e afatit të kontratës, pa qenë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.
- 3.4. Qiramarrësi do të gëzojë të drejtën e preferimit, në momentin e përfundimit të afatit të kontratës, në rast se ai do të dëshirojë ta rinovojë.

Neni 4. Çmimi i kontratës dhe mënyra e pagesës

- 4.1. Çmimi total i qirasë mujore do të jetë 1,400 (Euro)/muaj për gjithë kohëzgjatjen e kontratës. Qiradhënësi merr për sipër likuidimin e taksës 15%, tatim mbi qiranë si dhe, çdo detyrim tjetër ndaj shtetit që lidhet me qiranë dhe objektin e kësaj kontrate.
- 4.2. Palët kanë rënë dakord që çmimi i qirasë mujore, do të paguhet prej Qiramarrësit më datë 5 të muajit.
- 4.3. Të gjitha pagesat do të bëhen në llogarinë bankare të Qiradhënësit:
Mbajtësi i llogarisë, shoqëria PF TRADE TIRANA sh.p.k., Nr .i Llogarisë 20184335302, Banka Intesa San Paolo.

Neni 5. Dispozitë e përbashkët për palët

- 5.1. Në rast se kjo Kontratë nuk do të ekzekutohet për motive që nuk varen nga asnjëra nga Palët atëherë Kontrata do të quhet e përfunduar që nga data e nënshkrimit dhe asnjë nga Palët në këtë Kontratë nuk do të kenë ndonjë detyrim ndaj Palës tjetrës.

Neni 6. Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit

Qiramarrësi, në bazë të kësaj kontrate ka të drejtë dhe merr përsipër sa më poshtë vijon:

Rau J. J. J.

J

këtë rast Qiradhënësi është i detyruar të paguajë një penalitet i cili do të përbëhet nga shuma totale e:

- a) Vlerës së investimeve të kryera nga Qiramarrësi në Pronë (të gjitha llojet e taksave të paguara të përfshira),
- b) Vlera e detyrimeve tatimore dhe vendore të paguara nga Qiramarrësi nga momenti fillimit të Qerasesh deri në momentin e zgjidhjes të Kontratës,
- c) Vlerën e një muaji qiraje, të depozituar si depozitë sigurie,
- d) vlerën bruto të 3(tre) qirave mujore.

Neni 13. Dispozita të fundit

- 13.1. Kjo Kontratë si dhe anekset e saj përbëjnë të gjithë dhe të vetmen marrëveshje ndërmjet dy palëve dhe përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse të palëve siç janë kërkuar dhe tentuar.
- 13.2. Kjo kontratë si dhe ndonjë klauzolë mund të ndryshohet vetëm me miratimin e të dy palëve, dhe ky miratim do të bëhet me shkrim në formën e shtesës (addendum).
- 13.3. Kjo Kontratë është hartuar në tre (3) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
- 13.4. Kjo marrëveshje përbëhet nga 13 nene.

PALET

QIRADHËNËSI

Për "PF Trade Tirana" sh.p.k.
Administratori
Rauf Fratari



QIRAMARRËSI

Për "Horizon" Sh.p.k.
Administratori
Vasilios Stachos



NOTERI
Majlinda Demollari

NOTERE
Majlinda E Demollari
NIPT: 581606040A
Tel: 0682061560